



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE MIRËMBAJTJES

Nr. _____ prot.

Himarë , më 01.12.2021

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike E-mail datë 20.11.2021.

Znj. _____

Përsa i përket kërkesës suaj për informacion depozituar pranë Bashkisë Himarë në mënyrë elektronike E-mail ju sqarojmë si më poshtë:

1-Pse Himara rezulton zona më e ndotur në vend?

-Himara është një nga bashkitë më të pastërta në vend, sigurisht që ka vend për përmirësim. Problemi më kryesor i cili përkon dhe me prodhimin më të shumta të mbetjeve urbane është sezoni turistik. Në sezonin turistik kemi vizitorë të shumtë të cilët vizitojnë zona të ndryshme që në shumë raste ka akses vetëm me det ose kafshë sic është plazhi i Gjipesë, plazhi i Krorëzës, plazhi Akuarium, etj duke lënë mbetjet e tyre që prodhojnë pa i marë me vete për në kontinierin më të afërt, rrugët lidhëse të këtyre zonave, rruga nacionale Llogara-Nivicë që mbetjet hidhen në mënyrë të papërgjegjshme në të dy krahët e rrugës, zonat arkeologjike etj. Kemi subjekte që nuk zbatojnë orarin e hedhjes së mbetjeve urbane por i hedhin këto mbetje në orët e para të mëngjesit dhe ne mbremje të derdhura jashtë kontinierëve të pastrimit pa qese plasmasi dhe mbasi është kryer shërbimi i pastrimit. Ne si institucion i kemi pastruar këto zona me aksione të ndryshme si nga deti dhe nga toka bashkë me punonjësit tanë.

2-Sa ton mbetje prodhon Himara (qyteti dhe zona bregdetare) në një ditë? Po në një vit?

-Mesatarisht bashkia Himarë prodhon 11.24 ton/ditë, për vitin 2020 kishim 4,104 ton, cdo vit kemi një rritje 13-15%

3-Ku depozitohen mbetjet? Sa kushton?

- Mbetjet depozitohen në landfillin Bajkaj me një kosto 22doll/ton

4-Sa është fondi i Bashkisë për pastrimin?

- Fondi për pastrimin është 75,000,000leke, përfshin zërat e mëposhtëm
- 1. Fshirje me fshese dore e rrugeve dhe shesheve
- 2. Grumbullimi e transportimi i mbeturinave urbane
- 3. Larja e konteniereve
- 4. Lagjia e rrugeve dhe shesheve me mjet teknologjik
- 5. Heqja e mbetjeve inerte e vol. nga pikat e grumbullimit
- 6. Grumbullimi e transportimi i mbeturinave ne plazhe
- 7. Ndarja e sist. i mbeturinave ne vend depozitim e kompostim
- 8. Edukimi public dhe ambjental i qytetareve
- 9. Depozitimim e mbetjeve në Bajkaj Landfill

5-Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve bashkia e Himarës e ofron në të gjithë territorin e saj apo një pjesë mbetet pa shërbim?

-Nuk përfshihet Njësia Administrative Horë-Vranisht për arsye infrastrukture.

6-Sa është fondi i parashikuar për vitin 2022 për këtë qellim?

-Për vitin 2022 ky fond parashikohet të jetë 120milionë lekë duke futur dhe Njësinë Administrative Horë-Vranisht, zonat e reja me fshatrat Turistike me zërat e sipërpërmendura më lart.

7-A ka vendgrumbullime të paligjëshme në Himarë?

- Në Himarë nuk ka vendgrumbullime të paligjshme që nga 6-mujori i dytë i vitit 2015 koha që Bashkia Himarë filloi ti depozitojë mbetjet urbane në Landfillin Bajkaj.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin !

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro